



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2020:179665

Datë: 10.02.2021

Numri i dokumentit: 01493735

P.nr.726/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit I. M. nga fshati M. Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par 8 në lidhje me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1646/20 të dt.03.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 09.02.2021, në praninë e Prokurores së shtetit Sllavica Mavriq, të pandehurit I. M. të dëmtuarit V. L. pas shpalljes së aktgjykimit me datë 09.02.2021, me datë 10.02.2021 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

IPANDEHURI: I. M. nga i ati A. e ëma H. e vajzërisë A. i lindur më dt. ..., në fshatin Maxhunaj Komuna Vushtrrisë ku edhe jeton, me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me dt. 03.07.2020 rreth orës 18:20 në rrugën Magjistrale Mitrovicë-Prishtinë te fshati P./Vushtrri, në afërsi të pompës së benzinit “E. P.” duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të llojit “Renault Megane”, ngjyrë të bardhë me targa të regjistrimit ..., ka shkelur dispozitat e nenit 53 dhe 68 të Ligjit për Rregullat e trafikut rrugor, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, edhe pse ishte i vetëdijshëm se me një veprim të tillë mund të ketë pasoja të ndalura, por lehtësisht konsideroj se nuk do të vijë deri te pasoja ose do të mund ti parandalojë ato, por ka ardhur deri te pasoja kur fillon tejkalimin në vendin ku është e ndaluar, me qëllim të shmangies së kontaktit direkt me automjetin e llojit “ G. 4” ngjyrë të zezë, me targa të regjistrimit 01-917-MB, të drejtuar nga i dëmtuari V. L. nga ana e kundërt, del nga shiriti qarkullues jashtë rrugës, kurse ngasësi i automjetit tjetër për ti ikur edhe ai ndeshjes direkte, del nga shiriti qarkullues nga ana e djathtë, ku edhe vjen deri te ndeshja direkte në mes të automjeteve, me ç ‘rast i dëmtuari V. L. pëson lëndime të rënda trupore në formë të thyerjes së kockës distale të dorës së djathtë.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 8 në lidhje me par 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 8, 17, 23, 38, 40, 42, 46, 48, 69, 70 dhe nenit 370 të KPRK-së si dhe nenit 365, 450 dhe 463 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT Indrit Maxhuni i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne qoftë se i njëjti nuk do të kryej vepër penale në periudhën verifikuese brenda afatit prej dy (2) viteve.

Pala e dëmtuar Valmir Latifi lidhur me këtë çështje penale udhëzohet në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimi t të viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30 €).

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej katër dhjetë euro (40 €).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr-1646/20 e datës 03.12.2020, kundër të pandehurit I. M. nga fshati M.- Komuna e Vushtrisë, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par 8 në lidhje me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1646/20 të dt.03.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 08.02.2021, dhe në këtë seancë të shqyrtimit fillestar, i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar se, e pranon fajësinë ne te gjitha pikat e aktakuzës, dhe së është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtojë gjykatës që në të ardhmen që kjo vepër nuk do të përsëritet.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Prokurorja e shtetit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka deklaruar se jam i pajtimit me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të përcaktuar me nenin 248 par .1 dhe i propozoj gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë dhe që pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, i njëjti është penduar thellë për veprën dhe se i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë veprën, e veçanërisht sjellja e tij në gjykatë ku i njëjti është sjellë i kujdesshëm në gjykatë dhe ka pranuar se ka gabuar.

I dëmtuari ka pranuar fajësinë e të pandehurit, sa i përket kompensimit të dëmit material dhe jo material e ka informuar gjykatën se është në procedurë civile, dhe i njëjti e ka informuar gjykatën se i pandehuri ka treguar kujdes në raport me dëmin e shkaktuar ndaj ti.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri.

Provat e administruara dhe të vlerësuara në shqyrtimin fillestar

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Raporti i Oficerit me nr. 2020-BR-352 i dt. 13.08.2020, në të cilin raport është përshkruar aksidenti në mes të pandehurit I. M. dhe të dëmtuarit V. L., Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dyshuarit I. M. me nr. 2020-BR-352 i dt. 09.07.2020, i cili në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar rreth aksidentit të tij me të dëmtuarin V. L. dhe se i njëjti e ka ndjerë veten fajtor dhe ka shprehur keqardhje rreth këtij aksidenti, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të viktimës V. L. me nr. 2020-BR-352, i cili në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar rreth aksidentit që kishte ndodhur me dt. 03.07.2020, në mes tij dhe të pandehurit I. M., foto dokumentacion (28) sosh, Ekspertiza e fatkeqësisë së komunikacionit e dt. 30.10.2020, Raporti i Spitalit Sheikh Zayed – Qendra Emergjente për dt. 03.07.2020. Andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklaratimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale bazuar në nenin 370 par.8 është e sanksionuar me dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite. Gjykata duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë rënduese kjo gjykatë ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e lartë të dëmit të shkaktuar ndaj të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprën e kryer, është student, janë pajtuar me palët e dëmtuara dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale. Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par 2 të KPPK-së, ku është përcaktuar se “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e

udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”. Në rastin konkret i dëmtuari nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi për dëmin e pësuar material dhe jo material e shprehur në vlerë monetare dhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.726/2020, datë: 10.02.2021

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.